

VENDIM
Nr. 386, datë 27.6.2012

PËR PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E EKSPORTUESVE AUSTRIAKË QË DO TË ZBATOJNË PROJEKTET NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME AUSTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 932, datë 10.3.2011 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, për bashkëpunimin financiar”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministrit të Financave, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëria “Austrian Health Care Systems & Engineering GmbH (AHC)” caktohet koordinator i projektit për organizimin e tenderit për për zgjedhjen e eksportuesve austriakë që do të zbatojnë projektet në kuadër të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin financiar të datës 7 dhjetor 2010, sipas protokollit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet çdo ministri linje që, për procedurat e tenderimit për për zgjedhjen e eksportuesit austriak që do të zbatojë projektin në fushën e tyre, në kuadër të marrëveshjes së datës 7 dhjetor 2010, të bashkëpunojë me “Austrian Health Care Systems & Engineering GmbH (AHC)”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha